

PUBLIKIMI I SERISË KOHORE 2008-2012 PËR STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM

Duke filluar nga viti 2014, Banka e Shqipërisë harton dhe publikon bllokun e statistikave të sektorit të jashtëm të ekonomisë shqiptare (Bilancin e Pagesave, Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare dhe Borxhin e Jashtëm Bruto) në përputhje me standardin e rishikuar metodologjik të Fondit Monetar Ndërkombëtar- botimi i 6-të i Manualit të Bilancit të Pagesave

Për të siguruar një bazë të përshtatshme krahasimi dhe analize, Banka e Shqipërisë ka bërë të mundur rishikimin e periudhave paraardhëse, duke aplikuar metodologjinë e re. Ky rishikim siguron njëkohësisht, harmonizimin e treguesve statistikorë, krahasimin e tyre në vite, si dhe përmbush detyrime që rrjedhin nga aktet dhe rregulloret e Komunitetit Evropian dhe Bankës Qendrore Evropiane.

Nëpërmjet këtij publikimi Banka e Shqipërisë i ofron publikut serinë kohore 2008-2012 të bilancit të pagesave të rishikuar sipas metodologjisë së re.

Bazuar në praktikat ndërkombëtare, krijimi i serisë kohore 2008-2012 sipas M6BP, është realizuar përmes matricës së konvertimit të hartuar nga FMN.

Seria e re e përftuar ka këto karakteristika kryesore¹:

1. Nuk ka ndryshime në nivelet e tepricave të llogarive kryesore të bilancit të pagesave - llogaria korrente, llogaria kapitale, llogaria financiare, zëra të rezervës dhe zëri *"gabime dhe harresa neto"* – si dhe në vlerat e *"pozicionit neto"* të investimeve ndërkombëtare;
2. Zëri *"Shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët"* (*"mallra për përpunim"* në M5BP) është ri klasifikuar nga *"llogaria korente / mallra"* tek *"llogaria korente /shërbime"*;
3. Për elementët përbërës të statistikave të sektorit të jashtëm, M6BP ofron një version të sintetizuar të klasifikimit që Standardi i Llogarive Kombëtare bën për sektorët institucionalë. M6BP i klasifikon llogaritë e sektorit të jashtëm në katër sektorë institucionalë kryesorë:
 - a. *"Bankë qendrore"*, që (në M5BP) zëvendëson *"Autoritete monetare"* si sektor institucional;
 - b. *"Korporata depozitë-pranuese me përjashtim të bankës qendrore"*, që zëvendëson termin *"Banka"*;
 - c. *"Qeveria e përgjithshme"*, e pandryshuar nga M5BP;

¹ Më gjerësisht mbi ndryshimet në statistikave të sektorit të jashtëm sipas M6BP, konsultoni në adresën: www.bankofalbania.org/web/pub/shpjegues_per_ndryshimet_ne_publicimin_e_statistikave_te_sektorit_te_jashtem_sipas_bpm6_qershor_2014_2_6688_1.pdf

d. "Sektorë të tjerë", detajohet më tej në "Korporata të tjera financiare" dhe "Korporata jo financiare, ekonomi shtëpiake dhe institucione jofitimprurëse në shërbim të ekonomive shtëpiake".

4. Për elementë të caktuar të statistikave të sektorit të jashtëm, M6BP ofron një detajim të mëtejshëm të tyre:

- Në kahun e mjeteve zëri "Mjete të tjera" detajohet më tej në "kapitale të tjera" dhe "llogari të tjera të arkëtueshme", si dhe në kahun detyrimeve zëri "Detyrime të tjera" detajohet në "kapitale të tjera", "llogari të tjera të pagueshme" dhe "SDR"; gjithashtu në kategorinë "Investime të tjera" është shtuar nën zëri "Sigurime, pensione dhe skema standarde garancish"

5. Ndryshon përdorimi i "shenjës", sipas tabelës më poshtë;

	M5BP (ishte)	M6BP (bëhet)
Llogaria korrente dhe kapitale	Transaksionet në kredi paraqiten me shenjë "pozitive" dhe transaksionet në debi paraqiten me shenjë "negative"	Transaksionet në debi dhe në kredi regjistrohen me shenjë "pozitive"
Llogaria financiare	Rritja në mjete dhe ulja në detyrime paraqitet me shenjë "negative"; ulja në mjete dhe rritja në detyrime paraqitet me shenjë "pozitive"	Rritja në mjete dhe në detyrime paraqitet me shenjë "pozitive"; ulja në mjete dhe në detyrime paraqitet me shenjë "negative"
Bilanci i llogarisë financiare	Llogaritet si shumë e mjeteve me detyrimet	Llogaritet si diferencë e mjeteve me detyrimet

6. Ndryshimi më i rëndësishëm në regjistrimin e investimeve të huaja direkte (IHD)² është kalimi në terma "bruto" të prezantimit standard në statistikave të sektorit të jashtëm. Kjo do të thotë se të gjitha mjetet e investimeve jashtë vendit dhe atyre brenda vendit do të regjistrohen veçmas nga të gjitha detyrimet e investimeve jashtë vendit dhe atyre brenda vendit. Kjo mënyrë përlogaritjeje do të sjellë rritje në të dy krahët si në mjete, ashtu edhe në detyrime. Edhe pse manuali i ri ruan të njëjtët komponentë bazë të llogarisë "investime direkte", brenda zërave do të ketë nënkategori të cilat identifikojnë marrëdhëniet e ndryshme midis investitorëve.

Ndryshimet në serinë e rishikuar të bilancit të pagesave dhe atë të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare për vitet 2008-2012, paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Gjatë vitit 2017, Banka e Shqipërisë do të bëjë të mundur publikimin e serisë kohore 2003-2007 të rishikuar me metodologjinë e re M6BP.

² Më gjerësisht mbi ndryshimet metodologjike për statistikave të investimeve të huaja direkte konsultoni në adresën: www.bankofalbania.org/web/pub/investimet_e_huaja_direkte_8751_1.pdf

TABELA 1. NDRYSHIMET NË BILANCIN E PAGESAVE SI PASOJË E METODOLOGJISË SË RE M6BP

Bilanci i Pagesave (vjetor)	M6BP												Ndryshimi/Kalimi nga M5BP në M6BP											
	2008	2009	2010	2011	2012	2008	2009	2010	2011	2012	2008	2009	2010	2011	2012									
(në milionë euro)																								
Llogaria korrente	-1381.2	-1329.8	-1018.6	-1197.2	-978.0	-1381.2	-1329.8	-1018.6	-1197.2	-978.0	-	-	-	-	-									
Mallrat	-2431.5	-2303.7	-2082.7	-2241.6	-1999.2	-2608.5	-2430.1	-2293.3	-2511.3	-2226.2	(177.03)	(126.45)	(210.61)	(269.69)	(226.99)									
<i>Kredi</i>	917.5	750.7	1171.5	1405.5	1525.6	367.9	286.9	560.5	693.7	875.9	(549.60)	(463.78)	(610.98)	(711.85)	(649.73)									
<i>Debi</i>	-3348.9	-3054.4	-3254.2	-3647.1	-3524.8	2976.4	2717.0	2853.9	3205.0	3102.1	(372.57)	(337.32)	(400.37)	(442.16)	(422.74)									
Shërbimet	69.4	173.9	231.8	134.9	213.3	246.5	300.3	442.4	404.6	440.3	177.03	126.45	210.61	269.69	226.99									
<i>Kredi</i>	1687.8	1771.4	1750.7	1747.4	1673.2	1860.2	1897.7	1960.4	2017.1	1899.9	172.40	126.24	209.73	269.69	226.68									
<i>Debi</i>	-1618.3	-1597.5	-1518.8	-1612.4	-1459.9	1613.7	1597.3	1518.0	1612.4	1459.6	(4.63)	(0.21)	(0.88)	-	(0.31)									
Të ardhurat	44.0	-137.9	90.1	3.2	-71.7	44.0	-137.9	90.1	3.2	-71.7	-	-	-	-	-									
<i>Kredi</i>	321.1	269.4	286.3	216.4	188.5	321.1	269.4	286.3	216.4	188.5	-	-	-	-	-									
<i>Debi</i>	-277.1	-407.3	-376.4	-213.2	-260.1	277.1	407.3	376.4	213.2	260.1	-	-	-	-	-									
Transferata korrente	936.8	937.9	922.4	906.3	879.6	936.8	937.9	922.4	906.3	879.6	-	-	-	-	-									
<i>Kredi</i>	1117.4	1096.2	1076.6	1011.5	1026.5	1117.3	1096.2	1076.6	1011.5	1026.5	-	-	-	-	-									
<i>Debi</i>	-180.5	-158.3	-154.2	-105.3	-146.9	180.5	158.3	154.2	105.3	146.9	-	-	-	-	-									
Llogaria kapitale	78.2	84.9	85.5	84.9	81.4	78.2	84.9	85.5	84.9	81.4	-	-	-	-	-									
<i>Kredi</i>	134.0	153.1	159.6	154.8	157.9	134.0	153.1	159.6	154.8	157.9	-	-	-	-	-									
<i>Debi</i>	-55.8	-68.3	-74.1	-70.0	-76.4	55.8	68.3	74.1	70.0	76.4	-	-	-	-	-									
Llogaria financiare	1542.8	937.3	786.6	869.0	697.7	-1542.8	-937.3	-786.6	-869.0	-697.7	-	-	-	-	-									
Investime direkte	609.8	688.7	788.5	608.9	647.9	-609.8	-688.7	-788.5	-608.9	-647.9	-	-	-	-	-									
<i>Investime direkte jashtë</i>	55.4	-28.2	4.8	-21.4	-17.9	253.0	272.8	35.1	146.0	65.1	197.65	244.59	30.24	124.61	47.15									
<i>Investime direkte në Shqipëri</i>	665.2	716.9	793.3	630.3	665.8	862.8	961.5	823.6	755.0	712.9	197.65	244.60	30.24	124.61	47.15									
Investime portafoli	-24.6	12.7	232.1	71.4	-29.9	24.6	-12.7	-232.1	-71.4	29.9	-	-	-	-	-									
<i>Mjete</i>	63.5	15.4	-84.2	-86.7	-87.5	63.5	-15.4	84.2	86.7	87.5	-	-	-	-	-									
<i>Detyrime</i>	38.9	-2.7	316.3	158.1	57.6	38.9	-2.7	316.3	158.1	57.6	-	-	-	-	-									
Investime të tjera	957.7	235.9	-234.1	188.6	79.7	-957.7	-235.9	234.1	-188.6	-79.7	-	-	-	-	-									
<i>Mjete</i>	228.7	50.0	-186.3	-292.7	-296.9	-228.7	-49.9	186.3	292.7	296.9	-	-	-	-	-									
<i>Detyrime</i>	728.9	186.0	-47.8	481.3	376.6	728.9	186.0	-47.8	481.3	376.6	-	-	-	-	-									
Gabime dhe harrresa neto	-49.5	278.5	325.4	214.6	276.2	-49.5	278.5	325.4	214.6	276.2	-	-	-	-	-									
Bilanci i përgjithshëm	190.3	-29.1	179.0	-28.7	77.3	190.3	29.2	-179.0	28.7	-77.3	-	-	-	-	-									
Mjete e rezervës	-190.3	29.1	-179.0	28.7	-77.3	190.3	-29.2	179.0	-28.7	77.3	-	-	-	-	-									

